



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	17 - 11 2021	viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSICK	5497/2021		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.845/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Jeton Koca dhe Malsore Gashi Bajraktari anëtarë, si dhe Sabile Avdyli -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.845/2021 të datës 04.10.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi rr “Dëshmorët e Gollakut” pa nr.Hajvali, kundër njoftimit të datës 30.08.2021, në çështjen juridike “masë disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 17.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.845/2021 e datës 04.10.2021 e parashtruar nga ankuesi
- II. **Anulohet** vërejtja e datës 30.08.2021 e shqiptuar nga u.d. udhëheqës i sektorit për transport dhe trafik në Komunën e Prishtinës.
- III. **Obligohet** Menaxheri i Personelit që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë ditësh (15)ditësh të bëjë zbatimin e këtij vendimi nga dita e pranimit të tij, duke larguar nga dosja personale vërejtjen e datës datës 30.08.2021 nga udhëheqës i sektorit për transport dhe trafik në Komunën e Prishtinës.

A r s y e t i m

Ankuesit, i punësuar në pozitën Zyrtar i lartë për infrastrukturë rrugore në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, mbrojtje dhe shpëtim, me datën 30.08.2021 i shqiptohet vërejtje nga udhëheqës i sektorit për transport dhe trafik në Komunën e Prishtinës, me arsyetimin se ankuesi

nuk i ka kryer punët dhe detyrat që i takojnë sipas pozitës që e ka dhe përshkrimit të detyrave të punës.

Ankuesi i pakënaqur me vërejtjen e shqiptuar nga u.d. udhëheqës i sektorit për transport dhe trafik në Drejtorinë e shërbimeve publike, mbrojtje dhe shpëtim, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes postës më datë 30.09.2021 e regjistruar me datën 04.11.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 4873/2021 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për anulimin e vërejtjes të datës 30.08.2021 të shqiptuar nga udhëheqës i sektorit për transport dhe trafik në Komunën e Prishtinës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 07.10.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Komunën e Prishtinës. Më datë 25.10.2021 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Prishtinës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 04.10.2021 me numër protokolli 4873/2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail zyrtar i datës 12.08.2021; E-mail zyrtar i datës 22.07.2021; Njoftim i datës 01.09.2021; E-mail zyrtar i datës 30.08.2021; E-mail zyrtar i datës 03.08.2021; E-mail zyrtar i datës 30.07.2021; E-mail zyrtar i datës 19.07.2021; E-mail zyrtar i datës 16.07.2021; E-mail zyrtar i datës 30.08.2021; Vërtetim i datës 30.08.2021 me nr.01.nr.119-62; Ankesa e datës 19.07.2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokolli 3789; E-mail zyrtar i datës 28.08.2021; E-mail zyrtar i datës 12.03.2021; E-mail zyrtar i datës 28.04.2021; E-mail zyrtar i datës 20.04.2021; Vendimi i datës 01.06.2021 me nr.14-112/02-0098951/21 për caktimin e ushtruesit të detyrës; Diploma e datës 15.01.2009 me nr.399 e lëshuar nga universiteti i Prishtinës për Akt noterial LRP.Nr.2157/2020; Shtojca e diplomës me numër protokolli 774 e datës 16.06.2021; kopja e letërnjoftimit ; Përgjigje në ankesë e datës 25.10.2021 nga organi i punësimit bashkë me këto shkresa: E-mail zyrtar i datës 02.08.2021; Akt emërimi i datës 01.02.2017 me nr.112-982; Vendimi i datës 06.09.2021 me nr.14-112/02-186697/21 për caktimin e ushtruesit të detyrës; E-mail zyrtar i datës 11.06.2021; E-mail zyrtar i datës 04.11.2021 dhe raportet për muajin korrik dhe gusht 2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, **është e bazuar, sepse:**

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se vërejtja e shqiptuar me datën 30.08.2021 e shqiptuar nga udhëheqës i

sektorit për transport dhe trafik në Komunën e Prishtinës përmes e-mailit të datës 30.08.2021 është kundërshtim me nenin 47 dhe neni 48 paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik; ku përcaktohet se : **“Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë”**, e në këtë rast mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë është emëruar në kundërshtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, sepse udhëheqës i sektorit për transport dhe trafik në Komunën e Prishtinës është emëruar në bazë të Ligjit Nr.03/149 për Shërbimin Civil të Kosovës, e neni 85 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik **thuhet se:” Me hyrjen në fuqi të këtij ligji , shfuqizohet Ligjit Nr.03/149 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë ligj”**, andaj është obligim i organit kompetentë në këtë rast kryetarit të komunës dhe Menaxherit të personelit brenda këtij organi të kujdesen për zbatim të ligjshmërisë me rastin e nxjerrjes së akteve administrative dhe konstatimit nga organi kompetentë se një akt administrativë nuk është në harmoni me dispozitat ligjore në fuqi.

Poashtu bazuar në dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative që përcakton një akt të paligjshëm, respektivisht nenit 52 paragrafi 1.2 **specifikishtë thuhet :“organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë”**, nga se sipas shkresave të lëndës vërtetohet se vendimet e specifikuar më lartë për caktimin e ushtruesit të detyrës nga kryetari i komunës janë nxjerrë në kundërshtim me dispozitat ligjore që janë në fuqi dhe se kryetari i komunës nuk ka pasur kompetencë të nxjerrjes së këtyre vendimeve.

Andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesit është i bazuar sepse në bazë të nenit 32 paragrafi 4 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik përcaktohet se: **4. Përfundimisht, një pozitë e rregullt pune në Shërbimin Civil mund të plotësohet në rast të nevojës të zëvendësimit apo mungesës së përkohshme të një nëpunësi civil varësisht nga rasti, për një periudhë jo më të gjatë se 12 (dymbëdhjetë) muaj. Në këtë rast, procedurat e pranimit zhvillohen nga Njësia e Burimeve Njerëzore, në pajtim me rregullat e përcaktuara me këtë ligj për nëpunësin administrativ dhe mbështetës”**.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në bazë të provave të lëndës ka konstatuar se Drejtoresha e Shërbimeve Publike me datën 22.07.2021 ka inicuar procedurë disiplinore tek komisioni disiplinor për shkelje të rëndë disiplinore sepse prej momentit kur është emëruar udhëheqës i sektorit për transport dhe trafik në Komunën e Prishtinës nuk është lajmëruar në vendin e punës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se u.d i udhëheqësit të sektorit për transport dhe trafik në Komunën e Prishtinës me rastin e shqiptimit të vërejtjes për me arsyetimin se i njëjti nuk e ka kryer raportin për muajin korrik është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi sepse ankuesi e ka përgatitur raportin për muajin korrik dhe gusht dhe i janë përcjell Drejtoreshës së shërbimeve publike mbrojtjes dhe shpëtimit.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerret të gjitha veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligji

Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të inicojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda:A.nr.845/2021,datë 17.11.2021

Sabile AVDYLI


Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve në Komunën e Prishtinës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

